

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Jo propozime sa për t'u dukur", Haxhiu me dy poste për propozimin e PDK: Asnjë kërkesë s'ka ardhur
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/aktualitet/jo-propozime-sa-per-tu-dukur-haxhiu-me-dy-poste-pe-i1185867
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:32:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 17:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7b0f91eda5cbeefba780fd9280622f733fa813f7786b83af9234bb553fb24afc
TEKSTI	5f8db4ced63e398b1e6fffa9088d26ae138ab3d986e85e71fd68826169bf8940
PAMJA	578e76e712b5c72596cad1a939780a5bee6a4e5ab95769d5938a3d16bf52839c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3db3b73c39f8c87637ea961001320c5ee5558b08b77baf198976887f75ddba89
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b795f32e8dcdad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3db3b73c39f8c87637ea961001320c5ee5558b08b77baf198976887f75ddba89>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Jo propozime sa për t’u dukur”, Haxhiu me dy poste për propozimin e PDK: Asnjë kërkesë s’ka ardhur



Nga Xhevahir Qardaku
25 Shtator 2026, 19:25 | Aktualitet



Kryesinë e Kuvendit e mbledhi, ndërsa aktualisht mban dy poste, kryeparlamentare dhe ushtruese e detyrës së presidentit.

Albulena Haxhiu sqaroi se për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme nevojiten firmat e të paktën 40 deputetëve, ndërsa tha se nuk ka ardhur asnjë kërkesë zyrtare nga PDK, që ka njoftuar iniciativë për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale.

“Janë bërë kritika në drejtimin tim se pse nuk kam thirrur një seancë të jashtëzakonshme pas vendimit të Hagës. Më lejoni që të sqaroj, nuk ka pasur asnjë kërkesë që është proceduar në Kuvendin e Kosovës për një kërkesë, pra kërkesë që ndërlidhet me mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme”, u shpreh Haxhiu.

Ndryshe deklaroi shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Arian Tahiri, që tha se e kanë dorëzuar në kuvend dhe qeveri, propozimin për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale. Parlamenti do të mbledhet të hënën e 28 shtatorit, ku mes tjerash do të miratohet dhe një deklaratë kundër dënimeve ndaj ish krerëve të UÇK-së në Hagë.

“Zonja Haxhiu u zotua se sot do të flasë me KM Albin Kurti që të përshpejtojë procedurat në Qeveri. Mos të mbajë 30 ditë, siç e parasheh rregullorja, por një ditë, të mblidhen ekspertët, të japin mendimin, të kthehet në Kuvend dhe mundet të hënën ose të martën të votohet ligji, nëse ka vullnet politik”, u shpreh Tahiri.

Kryetarja e Kuvendit, komentoi kështu projektligjin e proceduar nga grupi parlamentar i PDK:

“Refuzoj të mbështes çfarëdo iniciative që ka për qëllim vetëm me u dukur që po bëjmë diçka. Nuk po dua me paragjyku nismën e Partisë Demokratike të Kosovës, por i ftoj të gjitha grupet parlamentare që mos të bëjmë propozime vetëm sa për t’u dukur... paraprakisht, të paktën, të konsultohen ekspertët e fushës, e po ashtu ekipet mbrojtëse. Unë nuk mendoj që bëjmë mirë në qoftë se nuk i konsultojmë ekipet mbrojtëse për çfarëdo iniciative ligjore”, tha Haxhiu.

Sa i përket çështjes së presidentit, palët nuk duken afër një marrëveshjeje apo rruge të qartë për zgjidhjen e ngërçit, pavarësisht se afati i fundit është 6 tetori. Nga PDK theksuan se kjo temë nuk është aktuale për momentin, ndërsa Aleanca akuzoi Vetëvendosjen se nuk është serioze në këtë çështje.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

TE FUNDIT

Reforma Territoriale, edhe demokratët depozitojnë pr.ligjin: Pse duam 100 bashki

Ftesa e Ramës për dialog me drejtësinë, Sadushi: Pagat i zgjidh kushtetuesja, flasim për problemet e tjera

Rama mban sot fjalimin në OKB, merr pjesë edhe në Këshillin European të Korporatave

Fitili që mund të ndezë luftën, Tajvani përplas SHBA dhe Kinën, ja pse është i rëndësishëm

MË TË VIZITUARAT

“Po humbasim njerëzillëkun nga AI”, Paralajmërimi i fortë i Papës: Makineritë...

Sandër Simoni zgjidhet anëtar i KLGJ-së

“Rusia po gatuan diçka të madhe!” Alarmi i Polonisë: Nuk përjashtojmë një sul...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Nderohet heroi Bunjaku me monument, Banjska 3 vite pas sulmit terrorist: Veriu frymon lirshëm!



“UÇK” shkon në OKB, shqiptarët protestojnë pas dënimit të komandantëve në Hagë



Avokati i Hashim Thaçit: Tre gjykatësit e Speciales e njollosën UÇK-në dhe NATO-n



Albin Kurti takohet me Erdoganin në New York



Zhbërja e Gjykatës Speciale, Deliu-Kodra: Presim mbështetjen e partive të tjera



Haradinaj përkujton Ahmet Krasniqin: Rruga dhe ideali i tij për ushtri të rregullt u jetësuan

Latest Videos





Reforma Territoriale, edhe demokratët depozitojnë pr.ligjin:
Pse duam 100 bashki



Ftesa e Ramës për dialog, Sadushi: Pagat i zgjidh kushtetuesja, flasim për problemet e tjera



Rama mban sot fjalimin në OKB/merr pjesë edhe në Këshillin European të Korporatave



Fitili që mund të ndezë luftën, Tajvani përplas SHBA dhe Kinën, ja pse është i rëndësishëm

Shqipëria

Aktualitet

Kronikë

Politikë

Ekonomi

Sociale

Kulturë

Moti

Kosova

Kulturë

Sociale

Ekonomi

Politikë

Kronikë

Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani

Bota

Argëtim

Showbiz

Lifestyle

Kapur në kamera

Teknologji

Sport

Live Euro 2024

Futboll

Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta

A2 CNN në Izrael

31 Minuta

A2 CNN në Ukrainë

Lumi i kokainës

Ditari ndërkombëtar

Zbulio

Imagjinatë

Dëshmi

Facebook

Twitter

Instagram

YouTube

A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh

Kushtet e Privatësisë

Karriera

Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk

All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.